


Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
01 Nr./Br. 43101-231119
Data/Datum 19.08.2021
Gjakovë-Djakovica-Gjakova



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

Komuna e Gjakovës, përfaqësuar nga Kryetari I Komunës Z. Ardian Gjini

dhe

OJQ Let's Do It Peja, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Urim Xharavina

Neni 1

Sfondi

- 1.1. Ky Memorandum Bashkëpunimi përcakton termat për mirëkuptim, bashkëpunim dhe bashkëfinancim midis **Komunës së Gjakovës** dhe **Let's Do It Peja – LDIP** për të punuar së bashku në zbatimin e projektit **“Të Bashkuar për Ajër të Pastër”**.
- 1.2. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë angazhimin afatgjatë duke u dhënë qytetarëve zërin që të ndikojnë në reformat e sektorit publik përmes programeve të bazuara në prova, analiza, monitorime, dhe iniciativa konkrete të avokimit në përmirësimin e cilësisë së ajrit në Komunën e Gjakovës dhe Komunës së Pejës.
- 1.3. Objektivat specifike të projektit janë:
 - Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe ulja e ndotësve kryesorë të ajrit në komunat e rajonit të Pejës dhe Gjakovës;
 - Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në fushata avokuese për përmirësimin e cilësisë së ajrit;
 - Vetëdijësimi i bizneseve për instalimin e filtrave kundër ndotjes së ajrit;
- 1.4. Aktivitetet kryesore të projektit janë:
 - Instalimi i mjeteve monitoruese në rajonin e Pejës dhe të Gjakovës;
 - Identifikimi i ndotësve kryesorë të ajrit dhe monitorimi i aktivitetit të tyre;
 - Monitorimi dhe raportimi i cilësisë së ajrit në kohë reale;



- Ngritja e kapaciteteve të autoriteteve lokale për aplikimin e praktikave më të mira për ruajtjen e cilësisë së ajrit;
- Sensibilizimi i qytetarëve për të avokuar për ruajtjen e cilësisë së ajrit;
- Sensibilizimi dhe aktivizimi i sektorit privat në pastrimin e ajrit duke aplikuar filtrat për pastrim të ajrit;
- Hartimi/Përditësimi i politikave lokale për cilësinë e ajrit;
- Aktivizimi i një komiteti për mbikëqyrjen lokale të cilësisë së ajrit.
- Organizimi i aktiviteteve për pastrim dhe gjelbërim;
- Angazhimi i qytetarëve në praktikat pastruese të ajrit;
- Hulumtimi dhe vlerësimi i rrezikut shëndetësor që lidhet me ekspozimin ndaj ndotjes së ajrit për rajonin e Pejës dhe për rajonin e Gjakovës

1.5. Projekti financohet nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë me 79,10% në vlerë prej 60,000EUR, Komuna e Pejës 7,910EUR me 10.45% dhe Komuna e Gjakovës poashtu me 7,910EUR me 10.45%.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i bashkëpunimit është:

- 2.1.** Mbështetja financiare për monitorimin e cilësisë së ajrit që do të zhvillohet në vitin 2021 në Komunën e Gjakovës, në vlerë totale prej 7.910.00€.
- 2.2.** Monitorimin dhe hartizimin e përbashkët të ndotësve kryesor në Komunën e Gjakovës.
- 2.3.** Mundësoj zbatimin e aktiviteteve edukative vetëdijësuese në shkollat e Komunës së Gjakovës.
- 2.5.** Ofrimi i informacioneve dhe të dhënave statistikore për bizneset ndotëse në Komunën e Gjakovës.
- 2.6.** Gadishmëria e Komunës së Gjakovës për ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve lokale për aplikimin e praktikave më të mira për ruajtjen e cilësisë së ajrit;
- 2.7.** Gadishmëria e Komunës së Gjakovës për aktivizimin e komitetit për mbikëqyrjen e cilësisë së ajrit.

Neni 3

Përgjegjësitë

3.1 LDIP është përgjegjëse për menaxhimin e gjithë procesit, nga zhvillimi i procedurave transparente dhe të drejtën për përcaktimin e termave të referencës dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të projektit, deri në dorëzimin përfundimtar të drafteve dhe raporteve si dhe pranimin dhe aprovimin nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë dhe Komuna e Gjakovës.

3.2. LDIP është përgjegjëse për zhvillimin dhe menaxhimin e tërësisht të aktivitetetve të planifikuara në projekt propozim.

3.3. LDIP është përgjegjëse për menaxhimin e tërësishëm financiar dhe shpenzimet buxhetore sipas procedurave të Komisionit Evropian PRAG.

Neni 4

Afatet kohore

4.1. Projekti “Të Bashkuar për Ajër të Pastër” ka filluar me datë 01/01/2021 dhe përfundon me 31/12/2021.

Neni 5

Hyrja në fuqi

5.1 Ky memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të Komunës së Gjakovës dhe LDIP dhe do të mbetet në fuqi derisa të përfundojë projekti.

5.2 Ky memorandum mund të modifikohet me pëlqimin e ndërsjellë të përfaqësuesve të autorizuar nga Komuna e Gjakovës dhe LDIP.

Neni 6


Përmbyllja e memorandumit të bashkëpunimit

6.1 Memorandumi i bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjakovës dhe LDIP do të përmbillet në tërësi, pasi që të aprovohet raporti nga stafi përgjegjës komunal, ku LDIP siguron përfundimin e plotë të aktiviteteve të parapara.

Palët nënshkruese

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës




(Nënshkrimi dhe vula)

Gjakovë, 19.08.2021

(Data dhe vendi)

Urim Xharavina

Drejtor Ekzekutiv i LDIP


(Nënshkrimi dhe vula)

Gjakovë, 19.08.2021

(Data dhe vendi)